



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.2.2024

Nr: 20

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E FONDEVE VJETORE PARTIVE POLITIKE NË FORMËN E  
NDIHMËS FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n”, e 2, 65, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 15/2, pika 2, shkronja “e”, 19, pika 2, 23/3, pika 2, dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021” dhe vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”,

V Ë R E J:

Neni 15/2, pika 2, shkronja “e”, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” ka parashikuar fondin prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2024.

Neni 19, pika 2, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

- 70 për qind sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- 20 për qind në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike, që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- 10 për qind sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 përqindësh dhe u ndahet partive parlamentare.

Data: 20.2.2024 Nr: 20  
Ora: 11:30



“Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2024”

Në zbatim të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, si dhe të vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”, shuma e dhënë nga buxheti i shtetit për t’u shpërndarë partive politike si ndihmë financiare vjetore është si më poshtë:

- a) Përlllogarisim 70% të vlerës totale 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekëve të miratuar nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë është e barabartë me 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milionë e nëntëqind e njëzet mijë) lekë. Totali prej 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milionë e nëntëqind e njëzet mijë) lekësh pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140 deputetë. Rezultati 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë i dalë nga pjesëtimi shumëzohet me numrin e deputetëve të secilës parti politike që ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare (25 prill 2021).

Nr.	Partitë politike	Nr. mandateve	70 për qind sipas nr. të mandateve	Fondi total nga buxheti i shtetit
			241.920.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	127.872.000 lekë	
2	PD	50	86.400.000 lekë	
3	PDIU	2	3.456.000 lekë	
4	PBDNJ	1	1.728.000 lekë	
5	PR	3	5.184.000 lekë	
6	PAA	1	1.728.000 lekë	
7	LZHK	1	1.728.000 lekë	
8	PLL	1	1.728.000 lekë	
9	PL	4	6.912.000 lekë	
10	PSD	3	5.184.000 lekë	

- b) 20% e shumës totale ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike, që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Përlllogarisim 20% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë është 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë. Vlera 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e njëzet mijë) pjesëtohet me 11 (numri i partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare). Vlera 6.283.636 (gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë përfitohet nga secila parti politike, si më poshtë:

Nr.	Partitë politike	Nr. mandateve / 10.000 vota	20 për qind mbi 10.000 vota	Fondi total nga buxheti i shtetit
			69.120.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	6.283.636 lekë	
2	PD	50	6.283.636 lekë	
3	PDIU	2	6.283.636 lekë	
4	PBDNJ	1	6.283.636 lekë	
5	PR	3	6.283.636 lekë	
6	PAA	1	6.283.636 lekë	
7	LZHK	1	6.283.636 lekë	
8	PLL	1	6.283.636 lekë	
9	PL	4	6.283.636 lekë	
10	PSD	3	6.283.636 lekë	
11	NTH	10.217 vota	6.283.636 lekë	

c) Përlllogarisim 10% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë është 34.560.000 (tridhjetë e katër milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe shumëzohet me përqindjen përkatëse të partive politike të cilat kanë fituar mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvend.

Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021 ka fituar 48.67%, që i përkon vlerës 16.820.352 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga buxheti i shtetit.

Partia e Lirisë, në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021 ka fituar 6.81%, që i përkon vlerës 2.353.536 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga buxheti i shtetit.

Partia Socialdemokrate në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021 ka fituar 2.25%, që i përkon vlerës 777.600 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga buxheti i shtetit.

Koalicioni Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim PD-AN në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021 ka fituar 39.43%, që i përkon vlerës 13.627.008 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga buxheti i Shtetit.

Neni 65, pika 3, i Kodit Zgjedhor përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Referuar vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021”, dhe nenit 65, pika 3, të Kodit Zgjedhor, fondi prej 13.627.008 (trembëdhjetë

milione e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekësh nga 10% i vlerës së miratuar nga buxheti i shtetit i jepet Partisë Demokratike të Shqipërisë në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit.

Nr.	Partitë politike	Mbi 1%	10 për qind i vlerës totale	Totali për parti/Lekë
			34.560.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	48.67%	16.820.352 lekë	
2	PL	6.81%	2.353.536 lekë	
3	PSD	2.25%	777.600 lekë	
4	PD	39.43%	13.627.008 lekë	

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare në bazë të mandateve të fituara në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Kjo vlerë përlogaritet nga shuma totale e 10% të vlerës së miratuar nga buxheti i shtetit duke hequr vlerës totale të shpërndarë nga 10% dhe i takon vlerës 981.504 (nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e katër) lekë, dhe do të shpërndahet si më poshtë:

Nr.	Partitë politike	Nr. mandateve	Vlera e mbetur nga 10 për qind i vlerës totale	Totali për parti/Lekë
			981.504 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	518.794,97 lekë	
2	PD	50	350.537,14 lekë	
3	PDIU	2	14.021,49 lekë	
4	PBDNJ	1	7.010,74 lekë	
5	PR	3	21.032,23 lekë	
6	PAA	1	7.010,74 lekë	
7	LZHK	1	7.010,74 lekë	
8	PLL	1	7.010,74 lekë	
9	PL	4	28.042,97 lekë	
10	PSD	3	21.032,23 lekë	

Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2024 është shumatorja e të gjitha shumave që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme, si më poshtë vijon:

Nr.	Partitë Politike	70% - 2/a / lekë	20% - 2/b / lekë	10% - 2/c / lekë	Pjesa e mbetur e 10% - 2c1 / lekë	Totali për çdo parti / lekë
1	PS	127.872.000	6.283.636	16.820.352	518.794,97	151.494.783
2	PD	86.400.000	6.283.636	13.627.008	350.537,14	106.661.181
3	PDIU	3.456.000	6.283.636		14.021,49	9.753.658
4	PBDNJ	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
5	PR	5.184.000	6.283.636		21.032,23	11.488.669
6	PAA	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
7	LZHK	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
8	PLL	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
9	PL	6.912.000	6.283.636	2.353.536	28.042,97	15.577.215
10	PSD	5.184.000	6.283.636	777.600	21.032,23	12.266.269
11	NTH		6.283.636			6.283.636
	<b>Totali</b>	<b>241.920.000</b>	<b>69.120.000</b>	<b>33.578.496</b>	<b>981.504</b>	<b>345.600.000</b>

Referuar pikës 4 të nenit 19, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, “...Ndihma financiare vjetore, në çdo rast, jepet vetëm nëse partia politike ka dorëzuar, paraprakisht, raportin financiar të vitit paraardhës, sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n”, e 2, 65, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 15/2, pika 2, shkronja “e”, 19, pika 2, 23/3, pika 2, dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021” dhe vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”,

#### V E N D O S:

1. T’u shpërndaj fondin prej 345 600 000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh partive politike për vitin 2024, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

*Lidhja 1*

**TABELA TREGUESE E FONDEVE QË PËRFITOJNË PARTITË POLITIKE PËR VITIN 2024**

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i partisë politike</i>	<i>Fondi që përfitohet (lekë)</i>
1	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	151.494.783
2	Partia Demokratike (PD)	106.661.181
3	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	9.753.658
4	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)	8.018.647
5	Partia Republikane Shqiptare (PR)	11.488.669
6	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA)	8.018.647
7	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	8.018.647
8	Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)	8.018.647
9	Partia e Lirisë (PL)	15.577.215
10	Partia Social Demokrate (PSD)	12.266.269
11	Partia Nisma Thurje (NTH)	6.283.636
<b>TOTALI</b>		<b>345.600.000</b>